

## Integrimi, i kundërshtuar por i paevitueshëm

Nëse organizoni referendum mbi integrimin e serbëve në veriun e Kosovës, rezultati do të tregonte një kundërshtim të pjesës dërrmuese. Edhe pse Prishtina dhe popullata shqiptare publikisht përkrahin integrimin, sipas disa folësve, duket se as ata nuk e duan integrimin. “Askush nuk e dëshiron integrimin, por integrimi është një ‘djall’ i paevitueshem dhe ne duhet ta gjejmë një mënyrë ta bëjmë atë, dhe sa më herët që e bëjmë, aq më mirë”. Shqiptarët nuk janë të gatshëm t’i ndajnë përgjegjësitë shtetërore me serbët. As serbët nuk janë të gatshëm të marrin përgjegjësi. Si pasojë, kemi një integrim sipërfaqësor, dhe jo thelbësor dhe të qëndrueshëm, i cili në pjesën më të madhe varet nga teket e udhëheqësve politik, të cilët mund ta fuqizojnë apo dobësojnë atë madje përmes disa deklaratave politike. Këto kanë qenë konkludimet e shumicës së pjesëmarrësve të tryezës së rrumbullakët të organizuar nga Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) të mbajtur në Prishtinë më 22 shkurt 2016.

Kjo tryezë diskutimi është pjesë e projektit mbi marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, dhe normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës e Beogradit. Projekti përkrahet dhe implementohet në bashkëpunim me Departamentin Federal të Punëve të Jashtme të Zvicrës.

Shumë serbë të Kosovës ndjehen sikur nuk i takojnë asnjë shteti. Serbia është duke i larguar institucionet e saj, kurse institucionet e Kosovës të krijuara rishtaz, të cilat kanë për qëllim t’i zëvendësojnë ato serbe, nuk janë funksionale sa i përket ofrimit të shërbimeve për qytetarët, posaçërisht në veri. “Ne i kemi zgjedhur kryetarët e komunave dhe kuvendet komunale, por edhe dy vite pas, ata i shërbejnë vetëm vetes”, ka thënë njëri nga folësit. Ata marrin paga dhe benefite tjera, por ende nuk ofrojnë asnjë shërbim.

Struktura politike e Serbisë në Kosovë është shpërbërë dhe integruar në mënyrë graduale në sistemin e Kosovës. Policia dhe Mbrojtja Civile, të cilat janë konsideruar si më të ndjeshme, tashmë veçse janë integruar. Një marrëveshje mbi gjykatat është arritur, edhe pse implementimi i saj është duke u vonuar. Serbët e Kosovës brengosen se çfarë do të ndodhë me strukturat e shërbimeve: arsimin, shëndetësinë, si dhe një numër institucionesh tjera, siç janë zyrat postare të Serbisë. Shumë nga folësit kanë thënë se institucionet e Serbisë të cilat ofrojnë shërbime duhet të rregullohen, kurse Beogradit t’i lejohet financimi i tyre.

Ky raport i shkurtër bazohet kryesisht në diskutimet e kësaj tryeze të rrumbullakët, por edhe në diskutimet individuale. Konkludimet nuk paraqesin një konsensus, por reflektojnë pikëpamjet e pjesëmarrësve të ndryshëm. Jemi munduar të jemi të saktë dhe të balancuar në përmbledhjen e diskutimeve, dhe së këndejmi, kërkojmë mirëkuptim nga pjesëmarrësit diskutimet e të cilëve mund të mos jetë përfshirë në tërësi në këtë raport të shkurtër, për të cilin CIG mban përgjegjësinë e plotë. Diskutimi në tryezën e rrumbullakët është mbajtur nën rregullat e Chatham House.

## Përfundimet dhe rekomandimet

- 1. Të draftohet statuti i Asociacionit/Komunitetit.** Asociacioni/Komuniteti është çështja kryesore ndarëse mes serbëve e shqiptarëve sot. Ekziston një frikë e dukshme në mesin e disa partive politike shqiptare rreth Asociacionit/Komunitetit, të cilat besojnë se ai “e kthen Serbinë në Kosovë”. Një folës ka thënë se mënyra më e mirë për ti “çliruar këto parti nga kjo frikë” është draftimi i statudit, me ç’rast çdokush do të mund ta shihte se Asociacioni/Komuniteti nuk është “shtet brenda shtetit”, por thjesht një organizatë e cila synon t’i përmirësojë kushtet praktike të komunitetit serb. Sa më gjatë që mbetet e pazgjidhur çështja e statudit, aq më shumë njerëzit do të besojnë se ai me të vërtetë është një institucion “i dobët”. Disa nga pjesëmarrësit kanë shprehur dyshimet e tyre rreth ekipit ekzistues të përbërë nga katër serbë, dhe kapacitetit të tyre për të draftuar një statut të pranueshëm për të dyja palët. Ata kanë propozuar që Prishtina dhe Beogradi ta inicojnë krijimin e një ekipi ekspertësh për draftimin e statudit.
- 2. Të organizohen debate rreth substancës së Asociacionit/Komunitetit.** Debati rreth Asociacionit/Komunitetit deri më tash është marrë kryesisht me simbolizma dhe me ate se si i njeiti do t’i shtyente para çështjet nacionale, kurse roli dhe substanca e tij mbeten ende të paqarta, si për serbët ashtu edhe për shqiptarët. Serbët e Kosovës duhet të kenë debate publike rreth rolit konkret dhe përgjegjësiive të Asociacionit/Komunitetit: si do t’i përmirësonte Asociacioni/Komuniteti shërbimet për serbët e Kosovës? Si do ta përmirësonte arsimin dhe shëndetësinë? Çka do të përfitonin komunat me shumicë serbe nga një organizatë e tillë ombrellë? Si të reagohet ndaj frikës që Asociacioni/Komuniteti ka ngjallur në mesin e komunitetit shqiptar? Çfarë efekti konkret do të kishte në zhvillimin ekonomik? Në kuadër të planifikimit urban, a do të jetë në gjendje t’i ndalojë ndërtimet ilegale? Si do të hapte vende të reja punë?
- 3. Të përmirësohet cilësia e komunikimit mes përfaqësuesve serbë dhe qeverisë së Kosovës.** Komunikimi mes përfaqësuesve politik serbë dhe qeverisë së Kosovës ende dominohet nga çështje abstrakte dhe simbolike. Një folës ka thënë se zyrtarët serbë të qeverisë së Kosovës përmes deklaratave të tyre politike janë më shumë të interesuar për avancimin e karrierës së tyre se sa për interesat e serbëve të Kosovës. Shumica e pjesëmarrësve në diskutim kanë kërkuar që komunikimi të bëhet në lidhje me problemet konkrete me të cilat ballafaqohen serbët e Kosovës. “Nuk është aspak relevante për serbët e Kosovës ajo se kë e konsideron një ministër serb kryeministër të tij, Aleksandar Vuçiqin e Serbisë apo Isa Mustafën e Kosovës; relevante është që ai ministër të merret me problemet me të cilat ballafaqohen serbët”. Deklarata të tilla nuk i bëjnë aspak mirë komunitetit serb. Përkundrazi, ato thjesht e largojnë vëmendjen nga problemet reale. Kurse nga pikëpamja e shqiptarëve, deklaratat e tilla ndikojnë që serbët e Kosovës të portretizohen si kërcënim për shtetin e Kosovës. “Përfaqësuesit tanë lokal duhet t’i adresojnë problemet tona lokale. Le të merret Beogradi me çështjet nacionale”. Serbët e Kosovës janë ende skeptik sa i përket qeverisë së Kosovës. Njëri nga folësit ka thënë se zyrtarët shqiptarë zbulojnë lloj-lloj pengesash vetëm e vetëm për ta vonuar integrimin. Udhëheqësit politik shqiptarë të Kosovës duhet ta demonstrojnë qartë se serbët janë me të vërtetë të dëshiruar në Kosovë.
- 4. Të krijohet një diskutim i vazhdueshëm dhe thelbësor mes serbëve të Kosovës dhe partive opozitare të Kosovës.** Edhe pse opozita e Kosovës përkrah

integrimin e komunitetit serb, disa nga veprimet e tyre, me theks të veçantë kundërshtimi ndaj Asociacionit/Komunitetit, tregojnë të kundërtën. Serbët e Kosovës ia kanë frikën më së shumti programit të Lëvizjes Vetëvendosje (VV). Edhe pse ata deklarojnë se janë për një shtet qytetar - të drejta të barabarta individuale, e jo në baza etnike - ekzistojnë mospërputhje mes asaj që ata thonë, dhe asaj që programit i tyre promovon. Qëllimi kryesor i VV-së është bashkimi me një shtet tjetër bazuar në konceptin e përkatësisë së përbashkët etnike. VV-ja poashtu i preferon simbolet etnike shqiptare para simboleve qytetare të Kosovës. Nëse VV-ja nuk beson në Kosovë, atëherë si mundën serbët të besojnë në te? Shumë nga folësit kanë shprehur dyshimet e tyre rreth çfaredo mundësie të bashkëpunimit thelbësor me VV-në, por megjithatë kanë përkrahur ndonjë iniciativë eventuale për të diskutuar me ta. Disa folës kanë thënë se e kuptojnë zemërimin e shqiptarëve të Kosovës kur kemi deklarata të llojit “Unë jam ministër i Aleksandar Vuçiqit të Kosovës, jo i Isa Mustafës”, por besojnë se VV-ja reagon më tepër se ç’duhet ndaj deklaratave të tilla. “Nëse një ministër shqiptar i Kosovës do të thoshte ‘unë jam ministër i Edi Ramës, jo i Isa Mustafës’, a do të kërkonte VV-ja ndalimin e partisë së atij ministri?”, ka pyetur një pjesëmarrës. VV-ja mund ndjehet e kërcënuar nga përfshirja e Beogradit në punët e serbëve të Kosovës, por edhe serbët e Kosovës ndjehen po aq të kërcënuar nga programi i tyre politik, ka thënë njëri nga folësit. VV-ja vazhdon t’i përdorë çështjet etnike për ta mobilizuar popullatën. “Nuk është fshehtësi se krimi i organizuar dhe korrupsioni janë çështje më urgjente se sa Asociacioni/Komuniteti. Megjithatë, VV-ja përdorë Asociacionin/Komunitetin për t’i mobilizuar protestuesit kundër qeverisë”. Ky folës më tej ka shtuar se lajm i mirë është se çështjet etnike, qoftë mes serbëve apo shqiptarëve, nuk janë aq efektive si dikur në mobilizimin e njerëzve. Shumë folës kanë sugjeruar që përfaqësuesit politik serbë do të duhej të ishin me të vëmendshëm në deklaratimet e tyre publike, kurse VV-ja do të duhej të kishte qasje më pajtuese karshi komunitetit serb.

- 5. Serbët e Kosovës duhet të përfshihen në debatin rreth zgjedhjeve.** Serbët e Kosovës janë ende të ndarë rreth mundësisë së mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme. Disa nga ta thonë se mandati i kësaj qeverie duhet të shkojë deri në fund. Të tjerët mendojnë se një palë zgjedhje të reja do të mund të krijonin një përfaqësim politik serb më të mirë. Disa kanë qenë neutral sa i përket kesaj çështje.
- 6. Financimi nga Beogradi duhet të jetë tërësisht transparent në mënyrë që ta eliminojë frikën në mesin e shqiptarëve të Kosovës.** Financimi i Serbisë për serbët e Kosovës është kyç, njëjtë sikurse që remitancat e diasporës janë të rëndësishme për shqiptarët e Kosovës. As serbët e as shqiptarët nuk do të mund të mbijetonin pa këtë ndihmë financiare. Megjithatë, me qëllim të eliminimit të frikës në mesin e shqiptarëve, shumë nga folësit kanë thënë se Beogradi duhet të jetë tërësisht transparent sa i përket financimit, dhe të tregojë se ky financim i dedikohet përmirësimit të mirëqenies së komunitetit serb, e jo minimit të institucioneve të Kosovës. Një folës ka thënë se një komunitet prej 90 përqind, nuk do të duhej të ndihej i kërcënuar nga një komunitet prej 5 përqind.
- 7. Dialogu i Brukselit duhet t’i kushtojë më shumë vëmendje problemeve reale me të cilat ballafaqohen serbët në Kosovë.** Dialogu në Bruksel nuk merret me problemet reale të serbëve në Kosovë. Një urë mbi lumin Ibër nuk është problemi kryesor për serbët. Në fakt, zhvillimi ekonomik është problemi kryesor me të cilin ballafaqohen ata.

Pjesëmarrësit kanë ardhë në përfundim se serbët e Kosovës në institucionet lokale dhe qendrore duhet t’i përmbushin obligimet e tyre institucionale, kurse sukcesi i tyre duhet matur me

rezultatet e arritura për përmirësimin e jetës së komuniteteve të tyre. Edhe pse pjesëmarrësit kanë përkrahur një përfshirje më të fuqishme të serbëve në çështjet e Kosovës, ata kanë theksuar se serbët nuk do të duhej të përfshiheshin shumë në krizën brenda shqiptarëve, por as nuk do të duhej të ishin tërësisht indiferent, pasi që rezultati i krizës, që mund të jetë zgjedhje të parakohshme, do të kishte ndikim edhe tek ta.

Në konsultim me pjesëmarrësit e projektit dhe partnerët zviceranë, CIG planifikon ta vazhdojë këtë diskutim më fokus në çështjet të cilat CIG beson se do të mund të kontribuojnë në krijimin e një mirëkuptimi më të qëndrueshëm dhe në krijimin e parakushteve për zgjidhjen e problemeve.

## **Pjesëmarrësit**

**Milica Andric**, Menaxhere e Projektit, OJQ Aktiv  
**Jelena Djokic**, Këshilltare e Kryetarit të Komunës së Zveçanit  
**Dalibor Jevtic**, Ministër për Komunitete dhe Kthim i Kosovës  
**Vesna Jovanovic**, Drejtoreshë e Arsimit, Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Partesh  
**Vladeta Kostić**, Kryetar i Komunës së Graçanicës  
**Dragisa Krstovic**, Ish-anëtar i Parlamentit të Kosovës  
**Ljubisa Mijacic**, Analist, Zubin Potok  
**Petar Miletic**, Ish-nënkryetar i Parlamentit të Kosovës  
**Miodrag Milicevic**, Drejtor Ekzekutiv, OJQ Aktiv  
**Dragan Nikolic**, Kryetar i Komunës së Parteshit  
**Dusan Radakovic**, Drejtor, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike  
**Nenad Radosavljevic**, Drejtor, RTV Mir, Leposaviq  
**Nenad Rasic**, Anëtar, Parlamenti i Kosovës  
**Sanja Sovrlic**, Gazetare, RTV Mir  
**Rada Trajkovic**, Ish-anëtare e Parlamentit të Kosovës  
**Shpetim Gashi**, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Arber Kuci**, Bashkëpunëtor në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Inkluzive  
**Krystyna Marty**, Ambasadore e Zvicrës në Kosovë  
**Saskia Salzmann**, Sekretare e Parë - Këshilltare e Sigurisë Njerëzore, Ambasada e Zvicrës në Kosovë  
**Talia Wohl**, Zyrtare e Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrës